

20182284157

**LIGJ PËR GARANCI TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TË DETYRIMEVE SIPAS
MARRËVESHJES PËR HUA, TË DEDIKUAR PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT
"PARKU EOLIK BOGDANC - FAZA E DYTË", QË DO TË LIDHET NDËRMJET
BANKËS KREDITORE PËR RINDËRTIM - KFV DHE SHA ELEM**

Neni 1

Republika e Maqedonisë e garanton shlyerjen e detyrimeve dhe përmbushjen e dispozitave të Marrëveshjes për hua, që do të lidhet ndërmjet Bankës Kreditore për Rindërtim - KFV dhe SHA ELEM për financimin e projektit "Parku Eolik Bogdanc - faza e dytë" në shumë prej 18.000.000 euro, në afate dhe kushte të parapara në Marrëveshje për hua, nëse SHA ELEM nuk i plotëson dhe servison detyrimet e Marrëveshjes për hua.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshjen për hua, që do të lidhet ndërmjet Bankës Kreditore për Rindërtim - KFV dhe SHA ELEM për financimin e projektit "Parku Eolik Bogdanc - faza e dytë".

Neni 3

Të gjitha detyrimet që dalin nga Marrëveshja për hua nga neni 1 i këtij ligji, si dhe servisimin e huas do t'i kryejë SHA ELEM nga të hyrat që i realizon, në afate dhe kushte të përcaktuara në Marrëveshjen për hua.

Neni 4

Afati i pagimit të huas nga neni 1 i këtij ligji është 12 vjet, me grejs periudhë të përfshirë prej tre vitesh.

Shkalla e kamatës është shkallë fikse e kamatës dhe e njëjta në mënyrë plotësuese do të përcaktohet në ditën e nënshkrimit të marrëveshjeve.

Huaja do të paguhet në këste gjysmëvjetore që arrijnë për pagesë më 15 maj dhe 15 nëntor.

SHA ELEM do t'i paguajë Bankës Kreditore për Rindërtim - KFV provizion të njëhershëm në lartësi prej 0,75% të shumës së huas.

SHA ELEM do t'i paguajë Bankës Kreditore për Rindërtim - KFV provizion në lartësi prej 0,25% të pjesës së patërhequr të huas në nivel vjetor.

Neni 5

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella që rrjedhin nga Marrëveshja për hua dhe Marrëveshja për garanci, Ministria e Financave dhe SHA ELEM do të lidhin marrëveshje të veçantë.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë“.